

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission in
Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations Unies au
Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

T R A N S K R I P T

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS,
TË MBAJTUR MË 22 JANAR 2004

PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA,
ODRŽANE 22. 01. 2004. GODINE

JANAR - JANUAR
2004



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

RENDI I DITËS

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
2. Fjala e Kryetarit të Kosovës mbi gjendjen e përgjithshme në vend,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Tregti me naftë dhe derivatet e saja (2003/33),
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Kinematografinë (2003/36),
5. Shqyrtimi i propozimit për emërimin e anëtarit të Kryesisë nga radhët e komuniteteve të tjera (joshqiptare dhe joserbe),
6. Propozimi i rendit të ditës për Seancën tjetër plenare të 29 janarit 2004:
 - 6.1 Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Odën Ekonomike të Kosovës,
 - 6.2 Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për barazi gjinore,
 - 6.3 Shqyrtimi i dytë i Projektligjit kundër diskriminimit dhe
 - 6.4 Shqyrtimi i parë i Projektligjit për materialin fidanor.

ДНЕВНИ РЕД

1. Усвајање записника са претходне седнице,
2. Излагање председника Косова о општем стању у земљи,
3. Прво разматрање Нацрта закона о промету нафте и нафтним производима (200333),
4. Прво разматрање Нацрта закона о Киноматографији (2003/36),
5. Разматрање предлога за именовање члана Председништва из редова осталих заједница (неалбанске и несрпске),



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

6. Предлог дневног реда за пленарну седницу за 29. јануар 2004:
 - 6.1 Друго разматрање Нацрта закона о Привредној комори Косова,
 - 6.2 Друго разматрање Нацрта закона о Полној равноправности,
 - 6.3 Друго разматрање Нацрта закона против дискриминације,
 - 6.4 Прво разматрање Нацрта закона о садном материјалу.

AGENDA

1. Approval of the minutes from the previous meeting,
2. President of the Assembly speech regarding to the country general situation,
3. First reading of the Draft Law on Petroleum and petroleum products (2003/33),
4. First reading of the Draft Law on Cinematography (2003/36),
5. Review of the request regarding to appointment of a member to the Presidency, coming from the other Communities (non Albanian and non Serbian).
6. Proposal of Agenda for the Plenary Session on January 29 2004:
 - 6.1 Second reading of the Draft Law on the Chamber of Commerce of Kosovo,
 - 6.2 Second reading of the Draft Law on Gender Equality,
 - 6.3 Second reading of the Draft Law on Anti Discrimination and
 - 6.4 First-reading of the Draft Law on Propagation Material.

TRANSKRIPT

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 22 JANAR 2004

Seanca plenare e Kuvendit të Kosovës, u mbajt në sallën e Kuvendit të Komunës – Prishtinë.

Seancën e kryesoi Akademik Nexhat Daci, kryetar i Kuvendit të Kosovës.

Bashkëkryesues Xhavit Haliti, anëtar i Kryesisë së Kuvendit të Kosovës.

Seanca filloi punën në orën 10,00.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Mirëmëngjes kolegë e kolege deputetë. Mirëseardhje në Seancën e radhës plenare.

Materialet e nevojshme ju janë shpërndarë me kohë, e besoj se do të startojmë me kohë.

Miratimi i Procesverbalit, eventualisht nëse ka vërejtje, ato të bëhen si gjithmonë me shkrim.

Ndërsa, kënaqësi imja e veçantë është sot që pas themelimit të institucioneve për pikë të parë të rendit të ditës të kemi fjalën e presidentit Rugova.

Prandaj, foltorja është e juaja, zoti president. Urdhëroni.

(Duartrokitje)

PRESIDENTI I KOSOVËS IBRAHIM RUGOVA:

I nderuari zoti kryetar – Daci, të nderuar deputetë, të nderuar të ftuar, qytetarë të dashur të Kosovës, zonja dhe zotërinj,

Ndihem shumë i nderuar që kam mundësi të bëj këtë fjalim vjetor para Kuvendit të Kosovës – këtij institucioni të lartë të vendit tonë.

Në fillim, dëshiroj t'ju njoftoj se kam vendosur që fjalimi vjetor i presidentit të Kosovës të mbahet çdo vit në formë tradicionale – të enjten e parafundit të janarit.

Fjalimi i presidentit do të bëhet në formë solemne, në frymë të vlerësimit të gjendjes dhe të vizionit për kombin në fillim të vitit.

Zonja dhe zotërinj,

Në këto katër vjet e gjysmë në liri, Kosova ka pasur një progres të madh në të gjitha fushat e jetës. Mund të themi se këto ishin vite të forcimit të lirisë, të sigurisë, të ekonomisë dhe të demokracisë.

Ndërsa sot, pas afër dy vjetësh të ndërtimit të institucioneve shtetërore të Kosovës, do të them se këto institucione kanë funksionuar me sukses. Kjo ishte një periudhë e konsolidimit të institucioneve nacionale të Kosovës.

Me këtë rast, do të veçoja punën e Kuvendit të Kosovës, i cili ka miratuar me dhjetëra ligje sistemore, apo bazike dhe ligje të tjera, si dhe rezoluta e deklarata të ndryshme në interes të qytetarëve të vendit tonë.

Mendoj se gjatë kësaj kohe, Kuvendi i Kosovës ka kultivuar frymën dhe funksionimin demokratik të institucionit. Po ashtu, edhe Qeveria – me të gjitha ministratë ka funksionuar mirë dhe ka arritur të jetë një ekzekutiv i qëndrueshëm.

Presidenti i Kosovës është kujdesur për funksionimin e institucioneve dhe i ka ndihmuar ato me ide e propozime dhe ka luajtur rolin reprezentativ të popullit dhe të qytetarëve në vend dhe jashtë. Prioritet kryesor ka qenë ruajtja dhe forcimi i stabilitetit politik dhe shtetëror të vendit.

Mund të themi se kemi fituar një përvojë të mirë në funksionimin e pushtetit legjislativ, ekzekutiv e reprezentativ, si dhe të vendosjes së shtetit ligjor.

Do përmendim këtu edhe funksionimin e mirë të pushtetit lokal të vendit që – gjithnjë e më shumë po forcohet, e që ka gëzuar përkrahjen tonë.

Deputetë të nderuar,

Në planin ekonomik, Kosova ka pasur progres. Është forcuar sektori privat në të gjitha fushat, që sot përbën gjysmën e ekonomisë. Gjatë kësaj kohe, kosovarët kanë treguar shpirtin e tyre ndërmarrës dhe dinamik.

Element me rëndësi është edhe buxheti i Kosovës, që mbliidhet nga të ardhurat vetanake – çfarë tregon se Kosova është në gjendje të funksionojë si shtet.

Euro ka ndikuar në stabilitetin monetar dhe ekonomik. Qe dy vjet kemi pasur suficit, që do ta përdorim në mënyrë racionale. Herave të tjera, duhet të kujdesemi që buxheti të realizohet me kohë, sepse paraja e shpenzuar në kohën e duhur ka vlerën më të madhe.

Segment me rëndësi në fushën financiare është konsolidimi i bankave në sektorin privat të cilat duhet të lidhen me bankat ndërkombëtare dhe të ndihmojnë ekonominë e Kosovës dhe qytetarët përmes kredive të ndryshme për prodhim.

Do të bëjmë më shumë në stimulimin e eksportit të prodhimeve kosovare në tregjet ndërkombëtare dhe t'i zvogëlojmë barrierat e ndryshme që pengojnë këtë veprimtari.

Në masë të madhe është përmirësuar infrastruktura e përgjithshme dhe infrastruktura rrugore – nacionale e lokale – ku do të realizohen projekte të rëndësishme – si pjesa kosovare e autostradës Prishtinë-Durrës që ka edhe karakter ndërkombëtar.

Edhe trafiku ajror i Kosovës ka pasur sukses nga kompanitë e ndryshme, e sidomos me themelimin e Kompanisë Ajrore Kosovare dhe me modernizimin e Aeroportit të Prishtinës, dhe së shpejti të Aeroportit të Gjakovës.

Në fushën e telekomunikacinit, ka pasur progres në telefoninë mobile e fikse dhe tash po hyjmë në fazën e konkurrencës. Po ashtu do të forcohet sistemi i internetit për të gjithë qytetarët.

Zonja dhe zotërinj,

Gjatë kësaj kohe, është forcuar siguria publike. Policia e Kosovës sot ka një kontingjent të qëndrueshëm që duhet të specializohet për detyra të ndryshme.

Trupat Mbrotjtëse të Kosovës kanë arritur fazën e organizimit dhe do të kenë përkrahjen tonë në konsolidimin dhe profesionalizimin e tyre – që të jenë forcë e aftësuar për detyrat e veta dhe forcë mbrotjtëse në të ardhmen.

Në fushën e arsimit po realizohet procesi i reformave. Që të kemi një arsim kompatibil në zhvillimet ekonomike dhe demokratike të vendit do të angazhohemi për një kompjutorizim të shkollave që çdo fëmijë të ketë qasje dhe të mësojë gjuhën angleze, që po bëhet gjuhë e dytë në Kosovë.

Shëndetësia gjendet në etapën e reformimit dhe do të ndihmojmë që kjo fushë e rëndësishme të stimulohet dhe do të bëjmë përpjekje për vendosjen e mjeksësisë së lartë. Edhe farmaceutika kosovare ka arritur që të anëtarësohet në këtë fushë ndërkombëtare.

Çështjet sociale kanë qenë prokupim për kujdesin ndaj grupeve të caktuara sociale, për punësimin e tyre dhe për ndihma. Ne duhet të shikojmë mundësitë e konsolidimit të fondit të pensioneve, të invalidëve të punës dhe të luftës.

Spektori i bujqësisë ka pasur përparime dhe do të angazhohemi për stimulimin dhe subuencionimin e projekteve në këtë degë, siç vepohet në Bashkimin Evropian dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, si dhe në vende të tjera. Kosova ka një tokë fertile, që është në gjendje ta ushqejë popullin e vet.

Në fushën e mbrotjtjes së ambientit ka pasur kujdes të shtuar dhe duhet të bëjmë përpjekje për hartimin e planeve hapësirore nga komunat dhe për të gjitha qytetet e vendbanimet në harmoni me planin global hapësiror të vendit tonë, që është në përgatitje e sipër.

Gjatë këtyre viteve është punuar në fushën e sportit, por duhet të angazhohemi më shumë në ndërtimin e infrastrukturës sportive dhe të kultivohet fryma e garës dhe e miqësisë midis të rinjve. Do theksuar se disa federata sportive janë anëtarësuar në federatat ndërkombëtare si sukses i punës së tyre.

Në fushën e kulturës kemi pasur përparime të qëndrueshme dhe do të bëjmë më shumë për financimin e këtij segmenti me vlerë të vendit tonë dhe të afirmimit të këtyre vlerave kosovare në botë.

Kujdes të veçantë kemi pasur dhe edhe më shumë do të kemi për diasporën kosovare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe në Evropë, që t'i ndihmojmë në fushën e komunikimit me atdheun dhe t'i ofrojmë mundësi për investime në Kosovë, që tashmë disa e kanë filluar me sukses.

Në mënyrë të veçantë do të theksoja se gjatë kësaj periudhe është forcuar mendimi për njohjen formale të pavarësisë së Kosovës.

(Duartrokitje)

Të nderuar deputetë,

Viti, në të cilin kemi hyrë, do të jetë vit i progresit më të madh të Kosovës në të gjitha fushat, sepse kemi krijuar një bazë të mirë të zhvillimit. Institucionet e Kosovës do të koncentrohen më shumë në zhvillimin ekonomik, në procesin e privatizimit, në sigurimin e investimeve, në përkrahjen e sektorit privat dhe në krijimin e vendeve të reja të punës për të rinjtë e vendit tonë që duhet të krijojnë familje të reja.

Ne do t'i kushtojmë më shumë vëmendje zgjidhjes së problemit energjetik, që është element kyç për zhvillimin ekonomik të Kosovës. Duhet ta shikojmë mundësinë e koncesioneve që besojmë se shpejti ky Kuvend do të miratojë ligjin për koncesione që do të hapë perspektiva të reja. Ne duhet të mendojmë edhe për forma të tjera të energjisë alternative.

Në planin e brendshëm ne do të vazhdojmë të punojmë në integrimin e grupeve etnike apo minoriteteve në shoqërinë dhe në shtetin e Kosovës dhe në garantimin e mbrojtjen e tyre. Njëherësh dëshirojmë një vullnet më të madh të minoriteteve për integrim në shoqërinë dhe në shtetin e Kosovës.

Zonja dhe zotërinj,

Një kujdes të veçantë do të kemi për mundësinë e përfaqësimit të Kosovës përmes hapjes së zyrave në botën e jashtme apo formave të tjera. Në vitin 2002 kemi bërë një hap në këtë plan me emërimin e mikut të madh të Kosovës – senatorit Dol ambasador nderi të Kosovës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Kjo është një çështje vitale për Kosovën në këtë fazë të zhvillimit. Ne do të kërkojmë një liberalizim të vizave, sidomos për njerëzit e biznesit të Kosovës me vendet e Bashkimit Evropian dhe me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Një veprim të përbashkët do ta bëjmë me UNMIK-un rreth bartjes së kompetencave me qëllim të shtimit të efikasitetit të institucioneve të Kosovës. Ky është një proces që duhet ta zhvillojmë së bashku.

Zonja dhe zotërinj,

Një element tjetër me rëndësi do të jetë puna në vlerësimin e standardeve të paraqitura, të atyre që i kemi përmbushur dhe të atyre që do t'i përmbushim në

bashkëpunim me UNMMIK-un, OSBE-në dhe me KFOR-in. Ne mendojmë se këto standarde janë në të mirë të zhvillimit dhe të prosperitetit të vendit tonë e jo punë e nisur prej fillimit, sepse të gjithë e kemi pranuar se Kosova ka pasur progres të cilin duhet fuqizuar.

Deputetë të nderuar,

Njëherit do të punojmë dhe insistojmë në njohjen formale të pavarësisë së Kosovës - e cila gjë do të shpejtonte e stabilizonte proceset e brendshme ekonomike e demokratike dhe do të qetësonte këtë pjesë të Evropës, të botës dhe popullin e Kosovës - pra një Kosovë e pavarur, demokratike e paqësore – e integruar në Bashkimin Evropian, në NATO dhe në miqësi permanente me Shtetet e Bashkuara të Amerikës që është vullnet politik i popullit dhe i qytetarëve.

Vëmendje të veçantë do t'i kushtojmë kultivimit të marrëdhënieve të mira me fqinjët e vendit tonë dhe t'i përparojmë ato çfarë është politikë nacionale e Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Në vjeshtë na presin zgjedhjet e dyta nacionale të Kosovës së lirë. Ne jemi të bindur se do të kemi zgjedhje të mira e të qeta, sepse tash kemi një eksperiencë të mirë në këtë plan. Të gjithë duhet të kontribuojmë në këtë drejtim. Kosova e ka dhënë tashmë këtë provim. Do thënë se Kosova po hyn në fazën e një vendi normal dhe është e gatshme t'i pranojë obligimet ndërkombëtare.

Zonja dhe zotërinj,

Do t'i shikojmë të gjitha mundësitë e angazhimit tonë në ndriçimin e fatit të të zhdururve. Njëherish sot i kujtojmë me pietet të lartë të gjithë ata që rënë për lirinë, pavarësinë dhe demokracinë e vendit tonë.

Zonja dhe zotërinj,

Me këtë rast përshëndesim zotin Hari Hollkeri e UNMIK-un, ambasador Fieskin e OSBE-në, si dhe gjeneralin Kamerhof e NATO-n dhe KFOR-in që po bëjnë një punë ekselente në mbrojtjen dhe sigurinë e Kosovës. Po ashtu përshëndesim Korin diplomatik në kryeqytetin e Kosovës në Prishtinë. Njëherit përshëndesim institucionet ndërkombëtare financiare në Prishtinë dhe donatorët që po e ndihmojnë Kosovën.

Zonja dhe zotërinj,

Nga kjo Seancë solemne e Kuvendit të Kosovës përshëndesim presidentin Bush, kryeministrin Bler, presidentin Shirak, kancelarin Shroder dhe kryeministrin Berlusconi – që vazhdimisht e përkrahin Kosovën.

Përshëndetje të veçantë i bëjmë atit të shenjt papa Gjon Palit të dytë që gjithmënë lutet për Kosovën.

I nderuar kryetar Daci, në fund të këtij fjalimi, dëshiroj t'ju njoftoj se së shpejti do të fillojmë ndërtimin e pallatit presidencial – shtëpisë së bardhë të Kosovës dhe do t'ju ftoj – së bashku me deputetët e nderuar në këtë ceremoni solemne e të rëndësishme për vendin tonë.

(Duartrokitje)

Shpresoj se së shpejti do të takohemi në përrurimin e Sallës solemne të Kuvendit të Kosovës që po i përfundon punimet këto ditë dhe ju – deputetë të nderuar do të keni më shumë kushte për punë edhe më të suksesshme.

Zoti ju bekoftë! Zoti e bekoftë Kuvendin e Kosovës! Zoti e bekoftë Kosovën! Ju falemnderit.

(Duartrokitje)

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Zoti president, ju falemnderit në emër të deputetëve të Parlamentit të Kosovës për fjalën inspiruese. Ndërsa tash – kolegë deputetë do të kemi 15 minuta pauzë që të freskohemi pak e pastaj të vazhdojmë me rendin e ditës. Ju falemnderit.

(Vijoi pauza prej 15 minutash)

* * *

(Pas pauzës, Seanca vazhdoi punën)

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Unë mendoj se mund të vazhdojmë punën.

Më lejoni që, para se të kalojmë në pikën vijuese të rendit të ditës, të them se ka patur dhe ka kërkesa oficiale të një numri të grupeve parlamentare për të marrë fjalën lidhur me fjalën e presidentit. Unë vlerësoj se në rend dite është fjala e kryetarit të Kosovës dhe jo raport. Prandaj, vlerësimet e mia janë të këtilla dhe ju lus të kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës. Ju falemnderit.

Pika e tretë e rendit të ditës është: - Shqyrtimi ...

Ju lutem... Zoti, anëtar i Kryesisë, gjatë zgjatjes së seancës vendimet i merr kryetari i Parlamentit. Nuk e them se janë të drejta apo të padrejta, për atë ka procedurë. Prandaj, kolegialisht po ju lutem të uleni. Unë thash kam marrë vendim dhe nuk ka fjalë për këtë. Jam i vetëdijshëm...

(H. Hyseni - prej vendit – nuk dëgjohet qartë)

Unë e thash, në rend dite është fjala e kryetarit të Kosovës. Unë po e vlerësoj se duhet të vazhdojmë dhe ne do të vazhdojmë.

(Reagim nga vendi – nuk dëgjohet qartë)

Zoti Hyseni, ju falemnderit. Nuk jeni kryetar i grupit parlamentar. Uluni një herë. Unë thash ka pasë kërkesa oficiale nga një numër i grupeve parlamentare për të hapur debat. E thash të vërtetën. Unë, po e vlerësoj thash se nuk është në rend dite ndonjë raport apo diçka tjetër, por është fjala. Për fjalë nuk hapet debat, prandaj po ju lus që të procedojmë me rendin e ditës.

(B. Dugolli – prej vendit – nuk dëgjohet qartë)

Zoti Dugolli, unë thash mendimin tim dhe kur e jap një mendim gjithmonë është definitiv. Ju falemnderit.

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tregtinë me naftë dhe derivate të saj.

Sponsori i ligjit, ministri për tregti dhe industri do ta paraqesë fjalën. Urdhëroni fjala është e juaja zoti ministër.

Para se t'ua jap fjalën vetëm disa informata për këtë.

Projektligji iu është shpërndarë deputetëve më 5 dhjetor 2003, prandaj janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij në parim, konform Rregullores.

Debati i sotëm do të shërbejë vetëm për qëllime të përgjithshme – me vërejtjet kuptohet.

Prandaj, zoti ministër foltorja është e juaja dhe urdhëroni.

ALI JAKUPI:

Ju falemnderit zoti kryetar, anëtarë të Kryesisë, deputetë, ministra – ju falënderoj që më dhatë rastin të prezentoj para jush Projektligjin për tregti me naftë dhe derivatet e naftës në Kosovë.

Është ky prezentimi i dytë nga se në vitin e kaluar Kuvendi riktheu në rihartim Ligjin në fjalë dhe për këtë u bë një rishqyrtim i tërësishëm dhe u ndërtua një strukturë e re e këtij Projektligji si rezultat i angazhimit të spektrit më të gjerë të ekspertëve ligjor vendor dhe ndërkombëtar.

Projektligji është pjesë legislative e hartuar me profesionizëm dhe me standarde të Bashkësisë Evropiane, që konsiston në zhvillimin ekonomik të Kosovës.

Projektligji mbi tregtinë me naftë dhe derivate të naftës në Kosovë definojnë ngritjen e konkurrencës së lirë dhe lojale në fushën e tregtisë me naftë dhe të derivateve të saj në Kosovë duke mundësuar furnizim të rregullt të tregut të Kosovës, mbrojtje të konsumatorëve si dhe mbrojtje të ambientit.

Faktikisht Projektligji fokuson krijimin e këshillit i cili është i autorizuar të merret me çështjet e liçencimit, me procedura të aplikimit, me krijimin e kushteve normale të mirëvajtjes së tregtimit të naftës dhe të derivateve të saj në Kosovë dhe me masat që duhet ndërmarrë në rastet kur shkelen dispozitat e këtij ligji.

Janë të përcaktuara kushtet e zgjedhjes së anëtarëve të këshillit, si dhe afatet kur do të fillojë funksionimi i këshillit, natyrisht pas miratimit të ligjit.

Kompetencat e këshillit përkufizohen në sigurimin e të dhënave për të interesuarit për ushtrimin e kësaj veprimtarie, për lëshuarje, përtëritje, suspendim e tjera të liçencave, për ndjekjen e veprimeve konkurruese me qëllim të ruajtjes së stabilitetit në treg, si dhe të rregullave tjera për të penguar keqpërdorimet, korrupsionin e mundshëm dhe çfarëdo veprim që nuk është në funksion të zhvillimit të tregut të Kosovës.

Sipas dispozitave të ligjit, këshilli është përgjegjës t'i drejtojë të gjitha aktivitetet dhe punët në mënyrë transparente dhe jodiskriminuese që kanë të bëjnë me arritjen e qëllimeve të parashtruara e që janë në harmoni me marrëveshjet ndërkombëtare detyruese për Kosovën, me kërkesat e detyrueshme të Organizatës Botërore të Tregtisë dhe me rregullat e kriteret e Bashkësisë Evropiane. Janë të definuara kushtet për liçencim për të gjitha veprimtaritë që janë të ndërlidhura me importimin, transportin, depozitimin, distribuimin dhe shitjen e naftës e të derivateve të saj në territorin e Kosovës.

Për procedurat e aplikimit shërbejnë kriteret që janë transparente jodiskriminuese, si dhe saktësohen tarifat për lëshimin dhe përtëritjen e liçencave. Me këto procedura vëhet në pah racionaliteti dhe efikasiteti i dhënies së liçencave – natyrisht duke i përfshirë të gjitha kërkesat që dalin nga ky ligj për ta bërë një kontroll të mundshëm të procesit të mëtejme pasi që nafta dhe derivatet e saj për këtë treg gjithnjë duhet të importohen dhe i kanë specifikat e veta në të gjitha fazat e veprimit.

Në këtë Projektligj saktësohen mënyrat e veprimit për lëshimin e liçencave të reja, për liçencat ekzistuese, për përtëritjen e liçencave si dhe suspendimin dhe revokimin e liçencave.

Me qëllim të ruajtjes së të drejtave të biznesmenëve që ushtrojnë këtë veprimtari, mundësohet paraqitje e ankesave për padrejtësitë eventuale, që do të thotë se këshilli është i detyruar t'i rishqyrtojë parashtruesat në afatin e caktuar dhe t'i informojë parashtruesit lidhur me miratimin apo refuzimin e kërkesave.

Po a shtu, me dispozitat e ligjit – të pakënaqurit mund të ushtrojnë ankesë në Gjykatën Supreme.

Në suaza të furnizimit optimal të tregut të Kosovës me naftë dhe derivate të saj respektohen standardet e Bashkësisë Evropiane që kanë të bëjnë me cilësinë e derivateve, me gjenezën e tyre me qëllim të ruajtjes së ambientit, duke i zvogëluar gazrat e dëmshme për ambientin, duke eliminuar karburantet me specifikacion të ulët e tjera.

Një prej çështjeve të rëndësishme janë përkujdesjet e Ministrisë dhe përgjegjësia e saj për furnizim të rregullt dhe cilësor me derivate të naftës, duke përfshirë edhe rezervat emergjente dhe operative – për çka obligohen furnizuesit me naftë dhe shfrytëzuesit për destinime të caktuara për të pasur stoqe në sasi të caktuar për kohë të caktuar.

Për të liçencuarit krijohen marrëdhënie kontraktuese me ministrinë përkitazi me rezervat emergjente përderisa është në fuqi liçenca përkatëse.

Janë të përfshira sanksionet që kanë të bëjnë me praktikën mashtruese tregtare për prejardhjen e derivateve të naftës, emërtimin, emrin dhe identitetin e shitësit, çmimin e derivateve dhe përbërjen e cilësisë dhe sasisë së naftës dhe të derivateve të saj.

Për këtë çështje saktësohen dispozitat për intervenime të mundshme gjyqësore, madje dispozitat ndëshkuese në rast se nuk përfillen normat e këtij ligji. Dispozitat e ligjit zbatohen në mënyrë të shkoçitur edhe përmjet urdhëresave administrative të cilat Ministria është e obliguar t'i hartojë, miratojë dhe zbatojë.

Me këtë ligj krijohen mundësi për rregullimin e pjesës së tregtisë që ka të bëjë me naftën dhe derivatet e saj – produkte këto që sigurohen nga importi, mirëpo meqë në vete ngërthejnë specifika që janë të lidhura me pagesën e akcizave dhe të doganave si një pozicion i rëndësishëm për buxhetin e Kosovës është i nevojshëm që kjo pjesë e tregtisë dhe tregut të rregullohen me ligj të veçantë.

Prandaj, duke i marrë parasysh nevojat dhe vlerat që dalin nga dispozitat e këtij ligji, propozoj që Parlamenti ta miratojë, sepse zbatimi i tij do të jetë efektiv për stabilizimin e pjesërisht të tregut të Kosovës, për ruajtjen e ambientit, për mbrojtjen e konsumatorëve, për zvogëlimin e keqpërdorimeve dhe të korrupsionit, si dhe për ndikimin e zhvillimit ekonomik të Kosovës. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Zoti ministër, ju falemnderit. Dua vetëm t'ju përkujtoj s'pari. Radha e diskutuesve, sipas Rregullores është kryetarët e komisioneve – mendohet sigurisht në atë funksional, kryetarët e grupeve parlamentare, anëtarët e Kryesisë dhe deputetët sipas radhës së paraqitjes.

Prandaj, s'po shoh se ka të paraqitur ndonjë kryetar të komisionit, por ka të grupeve parlamentare.

Në emër të LDK, zoti Fatmir Sejdiu, pastaj le të bëhet gati Dragisha Kërstoviq, i paraqitur në emër të «Povratakut».

FATMIR SEJDIU:

Të falemnderit, zoti kryetar. Të nderuar deputetë, zotri ministra,

Projektligjin që e kemi para vetes paraqet një nga projektet e rëndësishme në rregullimin e materies nga kjo fushë tepër e nevojshme dhe tepër e ndieshme për Kosovën dhe mendoj në parim se Ministria ka bërë një punë të mirë në ofrimin e këtij Projekti duke pasur parasysh nevojën e rregullimit edhe të asaj materie që në një fazë paraprake nuk ka qenë e përfshirë, por se mendoj që me tërësinë e tij Projekti ofron një vizion të mbështetjes në parim, një përmbajtje që duhet të mbështetet në parim dhe ky është qëndrimi edhe i Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Megjithatë, mendoj se në procesin e mëtejshëm, në punën që do të bëhet në komisionet funksionale dhe, natyrisht kujtoj në bashkëpunim me vetë Ministrinë, të kihet parasysh edhe disa elemente të rëndësishme të cilat ky ligj përkatësisht tani si Projekt duhet t'i përmbajë në mënyrë që të marrë një fizionomi të mirë dhe të miratohet nga ana e Kuvendit.

Në strukturën e dispozitave që parasheh Projekti, mendoj se pikërisht në nenin 3 - çështja e këshillit, fushëveprimi i tij, organizimi dhe kompetencat – ka mbetur çështje e padefinuar sa duhet. Pikërisht, në radhë të parë, struktura e tij se si duhet të ndërtohet dhe prej kah, mandati i tij, se çfarë fuqie ka dhe këtu del pikërisht në përmbajtjen e dispozitave të mëvonshme se nganjëherë del edhe më tepër se vetë Ministria, relacioni i tij apo në këtë pjesë të mandatit çështja se nganjëherë mbetet si një trup fakultativ, i cili nuk ka një lidhje esenciale me punën që bën dhe praktikisht del se nga ajo që mund të bëjë apo s'mund të bëjë – del si një trup që realisht del gati i papërgjegjshëm.

Në çështjet e tjera, që kanë të bëjnë me dispozitat konkrete të ofruara, mendoj se posaçërisht duhet të kihet parasysh ajo fushë që ka të bëjë me çështjen e licencimit, e cila në nenin 5 pika 8 lejon një mundësi e cila me ligj nuk do të duhej të ishte kështu apo të ketë një formulim shumë më të drejtpërdrejtë se, ta zëmë – nëse në afatin prej 30 ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës këshilli nuk merr vendim për licencimin në përputhje me nenin 5 (6.pika a) deri në pikën d)) «Parashtruesi i kërkesës konsiderohet i licencuar dhe do të ketë të drejtë të kërkojë që këshilli së bashku me provat e siguruara, etj., etj. – të sigurojë». Mendoj se është një hapësirë shumë e pavend dhe le mundësitë që kjo të

keqpërdoret mirë dhe si e tillë praktikisht në procesin e një fetakompli që krijohet dalin probleme të tjera.

Çështje e posaçme është relacioni me sistemin e gjyqësisë, që kujtoj se nuk është ndërtuar si duhet dhe posaçërisht në një nga dispozitat sikur e përfundon nivelin e gjyqësisë në Kosovë jo drejt. Ta zëmë në nenin 9 pika 4 – «Vendimi i Gjykatës Supreme mund të kundërshtohet në pajtim me ligjin në fuqi!» Çka më tej? Do të jetë gjykata kushtetuese?! Paneli i posaçëm i saj? Apo do të jetë ndonjë diçka tjetër që s'duhet të sypozohet se është menduar asisoj.

Një segment i posaçëm është segmenti i statusit të objekteve ekzistuese, ta quajmë të ndërmarrjeve apo të deponive që merren me këtë fushëveprimtari. Mendoj se ligji, apo me ligj të veçantë – në mënyrë decedive duhet të rregullohet kjo materie. Nuk mund të lëhet e padefinuar çështja e tyre dhe statusi që kanë dhe procesi i inkorporimit të tyre në këtë fushë kaq të nevojshme.

Po ashtu, mendoj se terminologjia që është përdorur, ta zëmë: «Bashkësia Evropiane, Union Evropian» duhet të jetë adapt pikërisht me nevojën, ashtu siç është edhe e rregulluar dhe disa çështje të tjera që kanë të bëjnë posaçërisht me mundësitë e kompetencave të shtuara – them – jashtë fushës apo jashtë obligimeve të drejtpërdrejta të këtij këshilli dhe relacionet e tij me organet e tjera të Kosovës. Do të përkujtoja, ta zëmë, vetëm nenin 16 – çështja e pikës 3, se «këshilli mund të bashkëpunojë me Shërbimin Policor të Kosovës dhe agjencionet tjera (cilat janë?) në bazë të ligjit për ndihmë dhe lidhur me zbatimin e ligjshmërisë me rastin e shkeljeve... dhe do të marrë masa të përfshirjes së organit të autorizuar ligjor për ruajtjen e qetësisë, parandalimin e prishjes së qetësisë ose ndërmarrjen e masave përkatëse në rast se prishet qetësia!» Një diçka që s'është pjesë e fushës së tij të drejtpërdrejtë dhe janë pjesë të normave që duhet të rregullohen pak më ndryshe.

Janë edhe disa relacione të tjera që kanë të bëjnë me shkeljet dhe nuk kanë ndonjë definim të posaçëm se cili do të jetë institucioni që do të ndërmarrë veprimet për të mbarvajtur ky proces.

Pavarësisht them, plus me këto fakte që shtruam – Lidhja Demokratike mbështetë në parim këtë ligj. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit shumë. Zoti Dragisha Kërstoviq, le të bëhet gati Bajrush Xhemajli – jo pse s'e meritoni – i dyta përnga forca por me vonesë të paraqitur, ju lutem.

DRAGIŠA KRSTOVIĆ:

Gospodine predsedniče, dame i gospodo poslanici, gospodine ministre,

Mišljenja sam da je ovo zakon koji će, ukoliko bude još na nekim mestima popravljen od nekim amandmanima, biti prihvatljiv za Poslaničku grupu Koalicije «Povratak». Ja ću samo neke napomene, i da iskoristim prisustvo gospodina ministra. Mislim da je nešto pogrešno formulisano u članu 5. stav 6. tačka e) gde kaže «da neko može biti član odbora i da obnovi licencu ukoliko nije kažnjavan za krivično delo kaznom zatvora u trajanju od šest i više godina» - to je verzija na srpskom jeziku i verovatno je neka greška u nekom kucanju ili u nečemu drugome.

I mislim da, kada su u pitanju kaznene odredbe, to je član 15. da su tu neke stvari suštinski pobrkane. Naime, u članu 276. krivičnog zakona Kosova koji će početi da se primenjuje od 6. aprila ove godine je predviđeno krivično delo zagadjivanja okoline. A inače u opštim odredbama tog krivičnog zakona je propisano da kazna... novčana kazna ne može biti veća od 25 hiljada evra za bilo koje krivično delo, osim za krivična dela učinjena iz koristoljublja za koja ta kazna može biti daleko veća, čak mislim da može i do 500 hiljada evra. Pa je nelogično da i kad bi ovo bio prekršaj, kad bi ovo što je označeno ovde imalo obeležja prekršaja da će se neko ko zagadjuje životnu okolinu bavljenjem trgovinom nafte i naftnim derivatima da će biti kažnjen do 50 hiljada evra. Znači, to je nešto što jednostavno ne bi moglo da bude, a osim toga ne bi moglo da bude predviđeno ovim zakonom jer je to kao krivično delo već predviđeno krivičnim zakonom i ne samo da nema potrebe nego ne može ovde da stoji jedna takva odredba iz prostog razloga što ćemo od 6. aprila ove godine imati krivični zakon koji je obuhvatio to kao krivično delo i ne bi bilo nimalo uputno da dva zakona i stovremeno regulišu jednu materiju i da pravimo takvu jednu pravnu nesigurnost za građane i za one koji se bave ovom delatnošću i da – na kraju krajeve i pravosudne i druge organe dovodimo u situaciju da ne znaju koji će zakon kada da primene.

I na kraju, mislim da definitivno trebaju... bilo bi potrebno da ove radne grupe, koje rade inače bez Srba, bez članova iz Srpske zajednice da ovu završnu odredbu – to kad zakon stupa na snagu... Zakon nikako ne može da stupi na snagu danom donošenja. Može, eventualno osam dana po objavljivanju u nekom... Nekada može i danom donošenja, ali su to izuzeci koji se predviđaju nekim višim aktom, a u ovom slučaju se zna – to je propisano Ustavnim okvirom i zakoni stupaju na snagu onda kada ih proglasi Specijalni izaslanik Generalnog sekretara. I mislim da bi u Ministarstvu moglo da se jednostavno kaže toj radnoj grupi da oko te odredbe ne treba da imaju dilemu. Jednostavno,

nek prepisu ono što piše u Ustanvom okviru. I ako ne prepisu, nego ostane ovako, to neće proći – naravno. Ipak će se primeniti ono što sadrži viši pravni akt.

Mislim da ćemo posle amandmana, za koja očekujem da će biti u funkciji poboljšanja ovog zakona moći da damo... da prihvatimo ovaj zakon kao zakon koji može da reguliše jednu životnu oblast. Hvala.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit shumë, në veçanti në avancimet që janë bërë dhe që do të bëhen. Për fjalë është paraqitur zoti Bajrush Xhemajli. Para se ta fillosh Bajrush, vetëm një sekond. Lus deputetët dhe t'mos më hidhërohen: ata që nuk janë të paraqitur, jemi marrë vesh, në formën që është paraparë të mos më hidhërohen se nuk do t'ua jap fjalën dhe për hirë të punës cilësore, do të thotë a ta që kanë studiue ligjin dhe që mund të kontribuojnë, e jo që nxitohen nëpërmjet fjalëve të huaja. Urdhëroni, zoti Xhemajli, le të përgatitet Sebahate Grajçevci.

BAJRUSH XHEMAJLI:

Kryesi e nderuar, ministra të nderuar, kolegë deputetë,

Padyshim se Projektligji që kemi përpara është më i mirë se sa projektligji që është refuzuar nga ky Kuvend për t'u ripunuar. Dhe në këtë kontekst – Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e mbështetë këtë Projektligj dhe njëherit, si kryetar Komisioni, kam parasysh bashkë me Komisionin të gjitha këto vërejtje që u dhanë nga parafolësit e mij dhe që do të jipen këtu në mënyrë që ligji të dalë më i mirë dhe më praktik.

Edhe një herë po them se ne e mbështesim. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit shumë. Sebahate urdhëroni.

SEBAHATE GRAJÇEVCI:

Të nderuar deputetë dhe ministra,

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e përkrahë miratimin në parim të Projektligjit për tregti me naftë dhe derivatet e saj, por vërejtja jonë është ajo e njëjtë që e paraqiti edhe kolegu nga LDK e kjo është se duhet të qartësohet formimi dhe funksionimi i këshillit për dhënien e liçencave. Dhe vërejtje tjetër kemi te taksat sepse mendojmë se janë shumë të larta. E kam fjalën për taksat për dhënien e liçencës. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit shumë. Edhe një qartësim, sepse thanë: anëtarë të komisioneve. Anëtarë të komisioneve po, por duhet të paraqiten. Kësaj radhe, meqë ka qenë e paqartë – po dhe munden. Do të thotë, për hirë të rendit, ta rrespektojmë një vendim që e kemi marrë. Fjalën e ka deputeti Ramadan Kelmendi. Le të bëhet gati Ibush Jonuzi.

RAMADAN KELMENDI:

I nderuari kryetar, të nderuar deputetë, të nderuar ministra,

Vërtetë këtë propozimligj e kam përpunuar e lexuar, dhe në emër të LDK e edhe në emër të Komisionit do t'i paraqes disa sygjerime, të cilat – po se vlerësohen nga Komisioni funksional, do të shndërrohen në amendamente.

Kosova, natyrisht ka nevojë të madhe të ketë ligjin me të cilin do të rregullohet tregtia e naftës dhe e derivateve të saj, do të bëjë përpjekje që të rregullojë mënyrën e furnizimit, në veçanti shpërndarjen, cilësinë, sasinë dhe kualitetin, si një strategji kombëtare, duke eliminuar kontrabandën që ekziston sot në tregun e naftës dhe të derivateve me naftë. Por, që në fillim duhet theksuar se nuk është përcaktuar furnizuesi i vetëm apo i shumtë me këto derivate në Kosovë, gjegjësisht me naftën. Pastaj, mendoj se këtij propozimligji i mungojnë edhe disa çështje tjera. Do të arrihet të garantohet siguria e cilësisë të naftës; Obligimet për përmbushjen e tatimeve shtetërore nga të gjithë beznismenët që ushtrojnë këtë veprimtari; Mënjanimi i uzurpimeve të pompave të benzinës, zgjedhja e udhëheqësve të ligjshëm në sektorin e naftës; krijimi i konkurrencës lojale me furnizimin me naftë dhe derivateve të saj.

Theksoj në veçanti – është shumë e nevojshme të hiqet obligimi i furnizimit me naftë vetëm në pompat e caktuara të benzinës për automjetet zyrtare të ministrive, të Shërbimit Policor të Kosovës; të shëndetësisë, e tjera, e tjera, nga se në këtë mënyrë vetë kemi krijuar furnizimin e caktuar, keqpërdorimin, shërbimet jo të mira dhe kualitative, furnizimet e dobëta dhe një mori problemesh që rrjedhin nga këto pompa të caktuara paraprakisht për furnizim.

Edhe në sferën e biznesit me naftë dhe derivatet e saj duhet siguruar një ekonomi të shëndoshë, të bazuar në tregun e lirë të Kosovës duke nxitur sektorin privat të ligjshëm dhe jo atë që abuzon me këtë veprimtari.

Ende është duke vazhduar praktika e sqarimeve në hyrje të ligjit e termave, përkundrazi faktit se këtu shumëherë nga deputetët është kritikuar një formë e tillë dhe është kërkuar që të elimnohen. Në veçanti brengosë ajo që u tha nga parafolësit se si krijohet, kujt i përgjigjet, cilat janë të drejtat dhe autorizimet e këshillit, si dhe raporti i tij funksional në mes ministrisë dhe importimit të naftës. Bordi për rregullimin dhe vëzhgimin e sektorit të naftës në Kosovë është mirë që formohet, por jo vetëm të vëzhgojë, por të marrë detyrë dhe obligim, gjegjësisht përgjegjësi me ligj që të realizojë detyrat e veta në rregullimin e kësaj sfere, gjegjësisht në sektorin e naftës dhe derivateve të saj.

Ligji nuk i përcakton kushtet që duhet plotësuar, kërkesat për licencim, gjegjësisht lokacioni, mbrojtja e ambientit, transparencja në burimet financiare, largësia mes pikave të shitjes së naftës, punësimi ligjor gjegjësisht sigurimi i të punësuarve në mbrojtjen shëndetësore dhe në punë në pompat ekzistuese, kategorizimin e tarifave për licencë e tjera, e tjera.

Propozimligji nuk e parasheh as afatin e udhëzimeve juridike për kundërshtime në vendimin e bordit. Megjithatë, në propozimligj janë paraparë edhe masat ndëshkimore. Mjafton që të përcaktohet, të sqarohet dhe të saktësohet procedura e inkasimit dhe mënyra e llogarisë se kujt dhe në cilën llogari derdhen këto mjete.

Me të gjitha këto vërejtje, mendoj se ky propozimligj në këtë fazë duhet aprovuar dhe si i tillë të plotësohet me amendamentet plotësuese. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Ibush Jonuzi, le të bëhet gati Gani Prekopuca, si anëtar i Komisionit.

IBUSH JONUZI:

Zoti kryetar, Kryesi e punës, deputetë të nderuar dhe ministra,

Projektligjin që sot po e shqyrtojmë e kishim edhe në vitin e kaluar, por atëherë u refuzua me qëllim që edhe një herë të shiqohet dhe mendoj se tani është dhënë forma dhe përmbajtja, të pranueshme për t'u aprovuar në parim.

Megjithatë, unë për tani kam disa propozime, meqë mendoj se Projektligjit të hartuar i mungojnë:

1. Ligji mbi naftën, të përcaktojë rastet kur furnizuesi i naftës dhe derivateve të naftës së saj mund të lirohet nga obligimet doganore; kush mund të lirohet; cilët sektor dhe sa mund të lirohen dhe deri kur vlejné lehtësimet doganore;
2. Duhet të caktohet tabela e peshës së naftës dhe e derivateve të saj në gjendje dhe temperaturë të caktuar dhe duhet të caktësohet sakt se në çfarë temperature ato mund të maten apo të bëhen llogari sipas tabelës së peshave nëpër stinët e ndryshme të vitit dhe në varësi të kushteve klimatike;
3. Duhet të caktohen mënyrat e kontrollit, revizionit të dokumentacionit mbi transportimin e naftës, kur mund të bëhet revizioni, në cilat raste, çfarë pasojash do të dalin nga revizioini;
4. Duhet të caktohet kuota për limitet së sasive të mjeteve përzierse të naftës, cilët komponente të përzierjes mund të përdoren, në çfarë përqindje dhe kur mund të përdoren;
5. Duhet të caktohet se në cilat raste mund të lirohet furnizuesi i naftës nga taksat në rast të fatkeqësisë.

Mendoj se nuk ka nevojë të thuhet në Projektligj se çka është parlamenti, pastaj çka është ministria, çka është ministri, sepse të gjitha këto dihen.

Dhe, në fund, kur thuhet se nuk duhet të ketë kufizime të dhënies së liçencave, është i drejtë një vendim i tillë, por në anën tjetër Ministria përkatëse duhet të ketë një strategji më të mirë në lidhje me këtë, s'pari për interes të atyre që investojnë në këtë lëmi e pastaj edhe për vetë Kosovën.

Këtë që e thash, do ta kisha paraqitur me një shembull konkret. Dihet largsia prej Mitrovice deri në Prishtinë, kurse në këtë relacion ka të ndërtuara 25 pompa të naftës dhe derivateve të naftës. Vetëm në vijën magjistrale, pra në çdo 1.920 metra nga një pikë karburanti.

Dhe, për fund, atë që e tha profesor Fatmiri e përshëndes dhe e përkrahu plotësisht. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Zoti Gani Prekopuca, le të bëhet gati Bedri Selmani, i fundit.

GANI PREKOPUCA:

I nderuari kryetar, të nderuar deputetë, zotri ministra,

Unë nuk kam ndonjë vërejtje të madhe për këtë ligj, por për habi për shtetet tjera si e bëjnë zakonisht bëhet ligji për energjetikë. Në suaza të energjetikës kuptohet hyn edhe kjo pjesa e naftës dhe e derivateve të naftës. Tani jemi duke punuar për ligjin për energjetikë, sigurisht ministri do ta ketë parasysh, por të bësh ligj për naftën dhe derivateve të naftës pa pasë ligjin mbi energjinë e përgjithshme që ka nevojë shteti apo vendi, është pak e pakuptimt.

Dy. Vërejtje në ligj, meqenëse ky mall është mall kryesisht prej burzës, nuk është caktuar me cilën valutë do të importohet. Për arsye se ju e dini, valutat në burzë mund të ndryshojnë dhe kurset e ndryshme të bëjnë edhe ndryshimin e çmimeve.

Nuk është cekur cila do të jetë akciza, e cila prapë po them – mund të ndikojë në çmimin final.

Nuk është cekur vendi prej kah do të mirret, për shembull nafta e papërpunuar apo benzina.

Këto ligji duhet t'i ketë parasysh për t'i ikur makinacioneve të ndryshme që njerëzit mund t'i keqpërdorin. Gjithësesi duhet t'i ketë parasysh, do të thotë caktimin e valutës, qoftë dollar apo euro – i cili do të mirret për vendin tonë; dhe

Tre. Më duket pak a shumë se ky ligj i ka ikur esenciales, për të cilën është menduar. Nuk dihen ndërmarrja e cila do të jetë ajo në nivel të Kosovë, nuk dihet këshilli i cili do ta përbëjë, kush janë ata njerëz, kush do të vendosë për përcaktimin e këtyre njerëzve. Lejohet mundësia që të stërshitet brenda kufijve

të Kosovës dhe të mirret çdokush me naftë dhe me derivate të naftës, që në shtetet tjera nuk lejohet një gjë e tillë.

Prandaj, kisha kërkuar që në të ardhmen t'i keni parasysh këto: Së pari kontingjenti energjetik; ndarja e atij kontingjenti i cili do të jetë i nevojshëm për Kosovën, naftën dhe derivatet e naftës. Kaq pata.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit shumë. Edhe zoti Bedri Selmani.

BEDRI SELMANI:

Zoti kryetar, zonja dhe zotërinj deputetë, zotri ministra,

Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tregtinë me naftë dhe derivatet e naftës nuk i plotëson kriteret themelore profesionale dhe si i tillë nuk krijon funksionalitetin në kushtet e një ekonomie të tregut. Janë tri arsye për këtë:

Në një. Ky Projektligj konceptualisht është i gabueshëm, sepse në vend që të jetë rregullator i mirëfillt i çmimit të tregut të derivateve të naftës, me qëllim që të sigurojë lojalitetin në treg dhe të mbrojë konsumatorët, ai mirret me rregullat dhe kushtet e funksionimit të kësaj veprimtarie, që është gabim.

Nën dy. Me rregullat dhe kushtet e funksionimit të kësaj veprimtarie me interes të veçantë për zhvillimin ekonomik të vendit duhet të mirret ligji mbi energjetikën, i cili ligj rregullon parimet e politikës energjetike, i cili ligj mirret me rregullat për veprimin e tregut të energjisë, me mënyrën dhe formimin e shërbimeve publike në ekonomi në lëmin e energjetikës; me parimet e furnizimit, me mënyrën e qeverisjes me veprimtari energjetike, me rregullat e dhënies së liçencave dhe kompetencat e organeve të pushtetit lidhur me kontrollin dhe qeverisjen e kësaj veprimtarie.

Nën tre. Ligji për tregtimin me naftë dhe derivate të naftës gati në të gjitha vendet me ekonomi të tregut është nënligj i ligjit për energjetikë, i cili, si i tillë edhe aprovohet nga parlamenti i këtyre vendeve dhe quhet rregull nënligjore mbi rregullimin e formimit të çmimit të derivateve të naftës që është nën kompetencat e qeverisë. Me këtë nënligj caktohen mekanizmat për formimin e çmimit të derivateve të naftës.

Prandaj, duke u bazuar në të gjitha këto argumente, Projektligji mbi tregtinë me derivate të naftës i propozuar si i tillë nuk mund të funksionojë pa aprovimin e ligjit mbi energjetikën nga ana e këtij Parlamenti, i cili duhet të jetë konform standardeve të Unionit Evropian me qëllim të kompatibilitetit dhe funksionalitetit sa më të mirë. Për këtë arsye, propozoj që ky Projektligj të refuzohet si i tillë. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit shumë. Ju falemnderit për kontributin. Të gjitha grupet parlamentare e kanë mbështetë ligjin në parim, prandaj ftoj deputetët që të deklarohen.

Kush është për aprovim në parim të këtij Projektligji? Ju falemnderit shumë.

A ka votë kundër? Dy vota kundër.

A ka abstenime? Dy abstenime.

Dy abstenime, dy vota kundër – kalon Projektligji në shqyrtimin e parë. Ju falemnderit shumë.

Votimi – Glasanje – Voted:

- Për – Za – ForShumica – Vecina – Majority.....
 - Kundër – Protiv – Against02.....
 - Abstenime – Uzdržani – Abstained.....02.....
-

Pika tjetër është: - Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kinematografinë.

Projektligji iu është shpërndarë deputetëve më 30 dhjetor 2003, prandaj ftoj ministrin sponsor të ligjit, zotin Behxhet Brajshori të marrë fjalën dhe arsyetojë ligjin.

BEHXHET BRAJSHORI:

I nderuari zoti kryetar i Kuvendit, të nderuar deputetë, të nderuar kolegë ministra,

Meqë para jush keni Projektligjin për kinematografinë, më lejoni që me rastin e paraqitjes së ekspozesë së shkurtër në lidhje me të – të tërheq vëmendjen tuaj në rrethanat që shtruan nevojën për hartimin e tij, si dhe për efektet që priten të arrihen me zbatimin e tij.

Hartimi i këtij Projektligji është rezultat i punës së Ministrisë së Kulturës, punës ekipore të ekspertëve vendës, i konsultimit të dokumenteve ndërkombëtare të fushës së filmit dhe i legjislacionit të një numri të konsiderueshëm të vendeve të Evropës, si dhe të ekspertëve të Këshillit të Evropës. Andaj, është ky rast i mirë i falënderimit për të gjithë ata të cilët ndihmuan në hartimin e këtij Projektligji.

Projektligji për kinematografinë përcakton bazat dhe parimet e organizimit, drejtimit dhe zhvillimit të kinematografisë si formë e të shprehurit artistik. Me këtë Projektligj krijohet qendra kinematografike e Kosovës me statusin e personit juridik, në varësi të Ministrisë së Kulturës.

Ligji për kinematografinë do të krijojë kushtet për një zhvillim të pavarur, të qëndrueshëm dhe të harmonishëm të kinematografisë së Kosovës.

Ligji i ri do të krijojë mundësi që me këtë veprimtari të merren të gjithë personat juridik e fizik, vendës e të huaj të regjistruar sipas ligjit, si dhe parashikon mundësinë e bashkëprodhimit të veprave filmike midis partnerëve vendas dhe të huaj.

Projektligjin për kinematografinë megjithatë po e diskutojmë në kohën e të arriturave modeste në këtë fushë. Ndonëse në kushte relativisht jooptimale për shkak të gjendjes së përgjithshme në Kosovë, kineastët tanë arritën që të sensibilizojnë mundësitë e tyre për t'u ballafaquar me rezultatet e artistëve dhe aktorëve më eminent edhe në arenat e filmit ndërkombëtar.

Projektligji promovon të drejtën e marrjes me veprimtari kinematografike, duke përcaktuar karakterin e parimit të profesionalizmit, si kriter esencial për ushtrimin e saj, dhe veçanërisht nxitë dhe mbështetë prodhimin e filmit vendës, nxitë dhe mbështetë aktivitetet për modernizimin dhe zgjerimin e rrjetit të kinemave, krijon e ruan lëndën filmike arkivore përkatësisht kinotekën, shkruarjen e skenarëve dhe sajimeve tjera të dramaturgjisë filmike, për regji e xhirim, për montim digjital të pamjeve filmike e të zërit, për animacion, për

menaxhimin dhe programimin e kinematografisë, nxitë frymën e konkurrencës pozitive dhe të bashkëpunimit midis producentëve dhe distributorëve.

Me këtë rast, shpresojmë se infrastruktura juridike, që tani po krijohet, do të jetë një faktor shumë i rëndësishëm për kinematografinë në Kosovë. Në fakt, qëllimi i Projektligjit që shtruar më lartë, do të jetë edhe përcaktimi i përgjegjësive të bartësve në këtë fushë mbi menaxhimin, organizimin, kushtet dhe mënyrat e ushtrimit të kësaj veprimtarie.

Kushtet për aktivitetin filmik do të nënkuptoheshin si kushte që duhet t'i plotësojnë producentët dhe distributorët vendës e të huaj, si dhe detyrimet që kanë kundruall qendrës kinematografike të Kosovës.

Siç thamë edhe më herët, në varësi të Ministrisë së Kulturës me këtë ligj krijohet qendra për kinematografi e Kosovës, si shërbim publik, me attribute të autoritetit qendror për kinematografi. Krijimi i kësaj qendre dhe i fondit për kinematografi konsiderohen zgjidhje optimale për zhvillimin e kësaj fushe dhe përkon me orientimet kryesore edhe në praktikën e legjislacioneve të vendeve tjera. Kjo qendër do të miratojë buxhetin dhe të hyrat e tjera të saj për tri gjeni të filmit: filmin artistik, dokumentar dhe të animuar. Qendra do të ketë bashkëpunim me institucionet simotra dhe financon prodhimin e filmit kosovar. Pastaj do të regjistrojë dhe licencojë filmat e realizuar ose të importuar, që do të shfaqen në territorin e Kosovës. Informon producentët për mundësitë financiare të saj, për ndryshimet në këshillat e saj, aktet nënligjore, pjesëmarrjet në festivalet kombëtare dhe ndërkombëtare të filmit.

Institucioni i qendrës kinematografike do t'i përmbushë detyrat dhe funksionin e tij në mënyrë të plotë e profesionale, si dhe në mënyrë të pavarur nga ndikimet politike duke rrespektuar parimin e transparencës dhe të mosdiskriminimit.

Përveç mjeteve buxhetore, si burimi kryesor, me ligj janë parashikuar edhe burime plotësuese. Këtu duhet theksuar si edhe në vende të tjera, një pjesë e mjeteve për zhvillimin e kinematografisë sigurohet nga takspagesat siç parashikohet me këtë rast edhe me këtë Projektligj.

Me dispozitat e aplikueshme, lidhur me takspagesat dhe me administrimin e tyre, është bërë hapi i parë për parandalimin e piraterisë në këtë fushë.

Projektligji përmbanë njëkohësisht edhe dispozitat e hollësishme lidhur me funksionin dhe përgjegjësitë, drejtimin dhe udhëheqjen, përbërjen e bordeve, të komisioneve dhe procedurat e vendimmarrjes.

Me këtë Projektligj parashikohen edhe mënyrat dhe bazat ligjore për dhënien e subuencioneve dhe stimulimeve të tjera me të cilat realizohet interesi publik,

kushtet dhe kriteret që duhet plotësuar aplikuesit si dhe detyrimet e kësaj qendre për të raportuar lidhur me aktivitetet e zhvilluara dhe menaxhimin e fondit për kinematografi.

Ashtu siç u tha edhe më lartë, Projektligji normon aktivitetet themelore të ushtrimit të veprimtarisë kinematografike në Kosovë, si veprimtari e interesit publik. Ai njëkohësisht përmbanë edhe dispozitat ndëshkimore për shkeljet e detyrimeve nga ana e të gjithë pjesëmarrësve aktiv në këtë fushë.

Të nderuar deputetë,

Në procesin e hartimit të Projektligjit është marrë parasysh një numër i madh i sygjërimeve në Seminarin me ekspertët e Këshillit të Evropës dhe të propozimeve nga debati publik. Në këtë mënyrë, ai i është përshtatur parimeve dhe standardeve ndërkombëtare të kinematografisë, por edhe kërkesave të kineastëve, aktorëve dhe krijuesve. Së këndejmi, ky Projekt, në gjiun e vet ruan edhe më tutje “Kosova-filmin” dhe vazhdimësinë e punës së tij si kompani publike për prodhimin, distribuimin dhe shfaqjen e filmave, si dhe për veprimtaritë tjera nga fusha e kinematografisë, që ia ngarkon Minsitria e Kulturës, përveç veprimtarive në përgjegjësi të qendrës kinematografike.

“Kosova-filmi” është në varësi të Ministrisë së Kulturës dhe mund të konkurojë me projekte filmike pranë qendrës nën kushtet e barabarta me producentët tjerë. Mjetet financiare për punën e tij sigurohen nga buxheti i Ministrisë së Kulturës, si dhe nga të hyrat që i realizon me shërbimet e veta dhe nga donacionet e tjera, duke siguruar transparencë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Ministria e Kulturës, të nderuar deputetë, është e ndërgjegjshme se Projektligji i propozuar ka edhe zbarztësi të veta veta juridike.

Në dispozitat kalimtare dhe të fundit, parashikohen afatet për organizimin e veprimtarisë, afatet për themelimin dhe fillimin e punës së qendrës kinematografike të Kosovës, afatet për nxjerrjen e akteve nënligjore në funksion të zbatimit të tij.

Ky Projektligj përmbanë edhe kornizën e domosdoshme ligjore, në bazë të së cilës do të arrihet mirëvajtja dhe avancimi i veprimtarisë kinematografike në Kosovë, me shpresë se do të vendoset rend e rregull mbi këtë fushë.

Të nderuar deputetë,

Do të dëshiroja të theksoja më në fund se ky Projektligj promovon një koncept bashkëkohor për kinematografinë i cili do të mund të jetësohej me një angazhim

të shtuar, qoftë të organeve përgjegjëse për kinematografinë, qoftë të bartësve të veprimtarisë filmike përgjithësisht.

Me shpresë se jam përpjekur që t'qartësoj parimet themelore, si dhe qëllimet dhe synimet e propozimligjit për kinematografinë, ju ftoj që ta mbështetni në parim të njëjtin.

Dhe, krejt në fund, të nderuar deputetë, ligji përkatësisht Projektligji që e keni ju përpara mund të ketë edhe lëshime teknike, siç ndodh me nenin 2 të Projektligjit, por që janë si rezultat i përgatitjes teknike në shërbimet përkatëse të Kuvendit. Ministria, së bashku me Kuvendin do të qartësojë këto gjëra dhe ju do ta keni tekstin ashtu siç edhe duhet. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUENDIT NEXHAT DACI:

Ministër, ju falemnderit. Komisionet nuk janë paraqitur për diskutim. Zoti Sabri Hamiti, udhëheqës i LDK.

SABRI HAMITI:

Kryetare e Komisionit është Edi Shukriu. Nëse ajo është gati, në emër të Komisionit mund t'flet. Ju lutem shumë.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

S'është paraqitur. Komisionet thash s'janë paraqitur.

SABRI HAMITI:

Eh, kush po na thotë! Po jemi shumë, ka ambicie shumë – normal!

Unë flas, natyrisht në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike dhe ne kemi biseduar dhe jemi marrë vesh që në parim këtë ligj do ta mbështesim, sepse është i domosdoshëm dhe është e domosdoshme që njëherë të krijohet një rregullativë rreth mundësive, unë po them – mundësive të prodhimit të filmave, të qarkullimit të tyre, të ruajtjes së tyre, e tjera – e tjera.

Meqë ne në parim do ta mbështesim këtë Projektligj, unë nuk dua të zgjatem shumë, vetëm se dua të sygjeroj dy-tri sende që më duken shumë me rëndësi të dihen që në këtë fazë të leximit dhe të trajtimit të tij.

Neni 6, që flet për censurën, mua më duket totalisht i panevojshëm, sepse paragjykon vetevetiu që s'do të ketë censurë të kurçkaje rreth filmit. Pse e them këtë? Sepse, menjëherë neni 12.3.2 zbaton në esencë ose propozon një tip censure, edhe pse s'e ka emrin ashtu. Aty ku vendoset që diçka të ndalohet – ajo censurë e ka emrin. Domethënë, ky duhet të dihet. Nëse ekziston neni 6, neni 12.2.3 bjen krejt, ose eventualisht s'ekziston as 6-shqi.

Tutje. Në kapitullin 3, sidomos neni 27, 28 dhe 29 nuk është materie ligjore por është program politik, ose program i Ministrisë, është punë e saj. Interessant duket ai tekst, po ai tekst në ligj s'ka vend. Unë mendoj se do të hiqet.

Tutje. Ajo që është e rëndësishme për këtë ligj dhe e re – unë do të thosha – në organizimin e prodhimit dhe t'distribuimit t'filmave është formimi i qendrës kinematografike, si një rregullator në nivelin institucional të kësaj veprimtarie. Unë kujtoj se funksioni i saj duhet shumëmirë të lexohet dhe të definohet. Sot s'do të bisedojmë për këtë. Do të kemi shumë shancë gjatë shqyrtimit të ligjit nëpër komisione dhe që ta bëjnë këtë.

Megjithatë, duhet të dijmë një gjë. Që ka elemente të dyfishta brenda ligjit. Ajo që quhet rregullativë shtetërore mbi prodhimin - ta quajmë - të filmave të cilët financohen nga buxheti, po ligji ka të bëjë në t'njëjtën kohë edhe me prodhuesit individual që s'kanë lidhje me fondet shtetnore ose buxhetore dhe duhet të gjendet strikt drejtpeshimi, sepse nganjëherë janë kombinuar të dy logjikat dhe pakashumë e përjashtojnë ose e pengojnë njëri tjetrin. Është pak problematike qysh qendra kinematografike do t'i kontrollojë – ta quajmë ne kushtimisht në bazë të këtyre dy-tre neneve që thash unë – njerëzit që financojnë me pare të veta prodhim të filmit. Qendra, në këtë rast do t'ketë ndonjë funksion licencimi në fillim, po tutje s'ka fuqi qendra kinematografike, që merret në esencë me veprimtarinë filmike që financohet nga fondi, po ashtu – po jo me ata që japin parat e veta, a? Sepse është kjo edhe ekonomi e tregut. Edhe në kulturë filmi është edhe industri edhe art, njëkohësisht – ashiqare a? Nuk është veç art. Siç është edhe veprimtaria botuese dhe e tillë quhet në Evropë e në Amerikë sot – a? Brenda saj hyjnë edhe ligjet, forcërisht ligjet e tregut.

Për fund, edhe një herë po përsëris që në këtë fazë ne përkrahim ligjin dhe ne mendojmë se do të saktësohen shumë çështje gjatë përpunimit. Falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Meqë kemi hyrë në radhën e përfaqësuesve të grupeve, zoti Lirak Çelaj, në emër të PDK-ës. Edit i kërkoj falje por do ta marrë fjalën, edhe pse nuk është paraqitur, do të thotë është paraqitur me vones. S'ka me dorë, por me shkrim. Urdhëroni ...

LIRAK ÇELAJ:

I nderuari kryetar, të nderuar kolegë, ministra,

Kinematografia kosovare pothuajse nuk ekziston fare. Edhe ajo krijimtari filmike që kishte filluar të zhvillohet në Kosovë u rrënuar definitivisht gjatë okupimit klasik të Serbisë. I gjithë aktiviteti i saj kishte dhe ka ngelur në videokaseta, që shumicën e rasteve kanë vlera të dyshimta ose nuk kanë vlera fare. Ky ligj, mendoj se do të rregullojë këtë dhe do të stimulojë prodhimtarinë e filmit.

Ligji, në përgjithësi është i mirë, edhe pse ka disa gabime esenciale, të cilat edhe u përmendën pak më parë dhe këto gabime esenciale do të mund ta shndërronin këtë ligj në ligj shkatërrues të kinematografisë. Por, besoj me intervenimet që do të bëhen në Kuvend, nuk do të ndodhë kjo.

Ajo që m'brengosë më së shumti, është kompetenca që ministri ia ka dhënë vetëvetes në qendrën kinematografike të Kosovës. Po them ministri vetëvetës, ngase kam kontaktuar me disa njerëz të cilët kanë marrë pjesë në përpilimin e ligjit dhe kur ua kam treguar ligjin i cili na është prezentuar në Kuvend më kanë thënë se ky nuk është verzioni që ata e kishin punuar.

Kjo nuk është hera e parë që ata të cilët zgjedhen nga ministri për të punuar përpilimin e projektligjeve na thonë kështu. Kam frikë se shpesh po manipulohet me fjali, si – po citoj: “Ky projektligj u vlerësua mjaft pozitivisht nga eksperti i sektorit” në këtë rast për kinematografi “në Këshillin e Evropës”, e tjera. Vërtetë disa ligje po lavdërohen, por jo verzionet që po na vijnë neve këtu në Kuvend. Është një tendencë e përhershme nga Ministria për Kulturë për të centralizuar gjërat, kurse në strategji të përpiluar nga kjo Ministri, thuhet e kundërta.

Para se t'ua jap shembujt dhe për të ilustruar këto që thash pak më parë, vetëm po ua kujtoj se SHBA nuk ka ministri të kulturës fare. Jo se nuk brengoset për kulturën, por ajo lavdërohet se është shumë demokratike me këtë punë dhe ka larguar nga influenca politike dhe iu ka lënë artistëve që vetë ta organizojnë jetën kulturore.

Ky ligj, parasheh krijimin e qendrës kinematografike të Kosovës, që është hap shumë pozitiv. Qëllimi i kësaj qendre do të duhej të ishte pikërisht decentralizimi dhe depolitizimi i kulturës. Kurse, në këtë ligj, neni 41, paragrafi 1 ku flitet për këshillin drejtues të kësaj qendreje, thuhet: “Këshilli drejtues përbëhet prej 5 anëtarëve të cilët i emëron ministri për kulturë”. Neni 43, i cili ka të bëjë me drejtorin e qendrës kinematografike të Kosovës, në paragrafin e saj të parë, ndër të tjera thotë: “Drejtorin e QKK e emëron ministri për kulturë”.

Pra, unë shtroj pyetjen – pse atëherë të themelohet një qendër e tillë, kur të gjithë do të jenë njerëz të ministrit dhe do të krijojë një monopol mbi filmin? Nëse këto evitohen, atëherë pjesa tjetër e ligjit, që ka të bëjë me QKK është e mirë dhe do të kishte kuptimin dhe funksionin e duhur, e në të kundërtën – jo.

Pika tjetër që mbetet për të diskutuar, është “Kosova-filmi”. Mendoj se ky institucion do të duhej të privatizohej dhe ekzistimi i tij, në të kundërtën, në kuadër të Minsitrisë së Kulturës vetëm sa do të ngarkojë buxhetin dhe do të krijohej problemi. Kemi mjaft shtëpi filmike private, të cilat do të mjaftojnë për të zhvilluar aktivitetet në këtë fushë.

Ka edhe disa vërejtje tjera që janë shumë më të vogla nga këto që u përmendën më parë, dhe të cilat - besoj - gjatë punës në Komisionin dhe grupe parlamentare do të mund të përmirësohen. Po i përmendi vetëm disa prej tyre. Memorandumi sqarues, mendoj është përpiluar shumë dobët dhe plotë gabime, por kjo nuk do të ndikojë në ligj, natyrisht. Pastaj, është se neni 2 mungon fare, që u përmend edhe nga vetë ministri, gabim teknik. Licencimi i domosdoshëm në QKK i producentëve, i distributorëve e tjerëve, mendoj se nuk do të duhej të ekzistonte obligimi i licencimit të tyre në QKK dhe kjo do të krijojë një paralelizëm të regjistrimit të veprimtarive, biznesit në këtë rast.

Filmat që përmbajnë dhunë dhe skenat tjera që nuk preferohen për të mitur, duhet të shfaqen pas orës 22, që është e mirë, por kjo duhet të ceket se vlenë vetëm për televizione e jo edhe për kinema. Kushtet që janë dhënë për t’u bërë anëtar i këshillit drejtues ose drejtor i QKK do t’i dëbojë ekspertët e filmit që të jenë anëtarë të saj, prandaj kam frikë që komisioni vlerësues dhe këshilli drejtues në kuadër të saj nuk do të jenë më të mirë për të vlerësuar, ngase është ngushtuar shumë fusha, do të thotë njerëzit që merren me këtë fushë kanë interesa për filmin dhe ata natyrisht do të paraqesin projekte dhe do të ikin nga konkurimi dhe me këtë rast nuk do të kemi njerëz që e njohin filmin shumë mirë dhe t’i vlerësojnë këto projekte.

Kreu i shtatë, neni 63, që ka të bëjë me distribucionin, mendoj se ka mbetur i mangut dhe sistemi i distribuimit duhet të përcaktohet me ligj e jo me rregullore, siç thuhet në atë nen.

Natyrisht, siç thash edhe më parë, ky ligj ka edhe disa gjëra shumë të mira, siç janë stimulimi i krijuesve të rinj, mbrojtja e tregut nga pirateria, edhe pse mendoj se kjo duhet të rregullohet me një ligj të posaçëm për mbrojtjen e të drejtave të autorit; mbledhja e taksave nga distribuimi i filmave dhe derdhja e këtyre mjeteve në fondin për kinematografinë...

Pra, në parim, Grupi Parlamentar i PDK megjithë vërejtjet që ka, do të përkrahë këtë ligj dhe do të japë vërejtjet e saj edhe me shkrim. Falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Edi, pastaj le të bëhet gati Mevlyde Saraçi.

EDI SHUKRIU:

Të nderuar deputetë, i nderuari kryeparlamentar,

E pranoj faljen që e kërkuat. Nuk hidhërohem për vonesë të dhënies së fjalës, sepse vërtetë edhe vetë me vonesë e kërkova fjalën. Faktikisht, nuk kam pasur ndërmend ta kërkoj fjalën, por desha dhe dola në këtë foltore të përkujtoj se në leximin e parë të projektligjeve...

(Ndërhyrje e kryetarit: Ju lutem, përkthimi le të funksionojë, sepse nuk ka përkthim!)

...A do të thotë të nisi prej fillimit? U bë. Desha vetëm të përkujtoj se në leximin e parë të ligjeve, deputetët kanë të drejtë ta mbrojnë në parim, por me faktin se ende nuk dihet cilit komision do t'i takojë ligji, faktikisht në parim mund të dihet si ligj për kinematografinë që i takon Komisionit për kulturë, rini dhe sport, po kjo s' do të thotë se kryetarët e komisioneve apo anëtarët e komisioneve duhet në emër të komisionit ta marrin fjalën në leximin e parë. Këtë desha ta përkujtoj.

Pasi dola në foltore, desha të them se në parim e përkrah këtë ligj. Komisioni do ta shqyrtojë në momentin kur kryetari i Parlamentit dhe Kryesia na japin këtë kompetencë. Që nga dita e nesërme do të merremi me këtë ligj. Presim të kemi edhe ligje të tjera të kësaj fushe.

Desha të përmend një përparësi që ka ky ligj që na është ofruar: është se paralelisht shkon në tri gjuhë. Është shumë më praktike që të përcillet dhe të mos ketë pastaj me rastin e amendamentimit probleme të tjera. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI.

Ju falemnderit shumë. Mevlyde, a doni fjalën apo jo? Falemnderit shumë. Xhevdet Neziraj, në emër të Grupit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.

XHEVDET NEZIRAJ:

I nderuari zoti kryetar, të nderuar zotri ministra dhe deputetë të nderuar,

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, jo vetëm që do ta përkrahë këtë ligj, por do të japë edhe kontributin e saj nëpër komisionet funksionale që ky ligj të jetë sa më praktik dhe më i zbatueshëm në Kosovë.

Unë do them se është një prej ligjeve i cili do ta pasurojë edhe jetën shpirtërore të një populli dhe të një vendi. Prandaj, Aleanca e përkrahë në leximin e parë dhe do ta përkrahë edhe në leximin e dytë. Falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI.

Të falemnderit shumë Xhevdet. LDK pak më e qetë. Po, shkruaje bre. Urdhëroni, në emër të Grupit Parlamentar të "Povratikut" dhe shkruani amanin ua kam – pismen jeni.

LJUBOMIR STANOJKOVIĆ:

Nisam znao da i u ime poslaničke grupe treba da se prijavljujemo. Ja sam mislio da to ide drugačijem procedurom, ali nema veze.

Generalno gledano, mi kao Poslanička grupa smatramo da je jedan ovakav zakon potreban. Jednostavno da se i ova oblast na neki način reguliše, odnosno na jedan pravi način reguliše ova oblast. Medjutim, imam osećaj da i ovaj zakon više je napravljen u smislu da popuni neku prazninu iz ove oblasti nego što će, recimo, da doprinese razvoju pre svega proizvodnji kvalitetnih dugometražnih filmova, jer za proizvodnju takvih filmova je mnogo više nečeg drugog potrebno nego neki papir odnosno neki propis. Ovaj, iz tih razloga, mi se i čini da ovaj zakon previše boluje državnosti, kao i većina zakona koji se predlažu na usvajanje ove Skupštine. Takodje, ovaj zakon ima dosta manjkavosti u smislu jezičkih grešaka, kada je u pitanju srpska verzija. Medjutim, opet smatram da ovaj zakon na neki način može da doprinese smanjivanju piraterije na području Kosova gde, čini mi se, da ima previše.

Iz tih razloga, Poslanička grupa Koalicije «Povratak» će u ovom momentu biti samo uzdržana, jer ne verujemo da će kasnije kroz neke amandmane da se ovaj zakon usavrši i bude prihvatljiviji po Srpskoj nacionalnoj zajednici. Toliko.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Zoti Gani Sadik, le të bëhet gati Zyhrije Maloku.

GANI SADIK:

Të falemnderit zoti kryetar. Përshëndetje të gjithëve. Në parim, Projektligjin ne do ta përkrahim, edhe pse në mesin tonë nuk ka ndonjë ekspert për këtë lëmi, por do ta japim votën.

I përshëndesim hartuesit e Projektligjit. Me të vërtetë një punë të madhe e kanë bë. Ishalla për t' mirën e Kosovës.

Në leximin e dytë, sigurisht se do ta përkrahim Komisionin funksional dhe do ta japim kontributin me arritjen e amendamenteve. Falemnderit.

KREYTARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit shumë. Zyhrije Maloku. I fundit, le të bëhet gati Sadik Idrizi. Më falni, do të thotë - i fundit jeni.

ZYHRIJE MALOKU:

I nderuari zoti kryetar, të nderuar ministra, kolegë deputetë,

Kosova deri më tani është ballafaquar me shumë vështirësi për faktin se i kanë mungaur shumë ligje për zhvillimin e mëtejme të infrastrukturës. Fillimisht përgëzoj Ministrinë për hartimin e këtij ligji dhe ligjeve tjera të miratuara në këtë Kuvend, të cilat do të rregullojnë shumë probleme të jetës së përditshme.

Me këtë ligj eliminohen zbrastësitë ligjore të çështjeve që kanë të bëjnë me kinematografinë. Ligji është përmbajtësor dhe strukturor. Është hartuar me një gjuhë të kuptueshme dhe jo me shumë gabime drejtshkrimore, edhe pse në fillim të ligjit nuk figuron se kush ka marrë pjesë në grupin punes, pra nga përvojat me ligjet tjera, por nga përmbajtja dhe shtjellimi i gjërave mjaft qartë na bën për të.

kuptuar se ligjin e kanë hartuar ekspertë me përvojë në fushën e kinematografisë.

Projektligji synon të rregullojë një materie shumë të rëndësishme dhe përmes këtij ligji afrohet një kornizë e mjaftueshme për organizimin dhe veprimtarinë kinematografike. Pra, vjen si nevojë e kahershme dhe e natyrshme për popullin e Kosovës. Sidoqoftë, vlenë të përmendet se ky ligj në brendi ka elemente të rëndësishme, të cilat do të ndihmojnë zhvillimin e kinematografisë. Po ashtu ka rregulla të cilat më parë nuk kanë ekzistuar apo ndoshta kanë ekzistuar por nuk janë përfillur. Një ndër to që mua më bën përshtypje, është kategorizimi i filmave duke u mbështetur në moshën e shikuesve, llojin e filmit dhe kohën e shfaqjes. Pra, me hyrjen në fuqi të këtij ligji, do të zvogëlohen turmat e mëdha të shikuesve që i shohim çdo ditë para dyerve të kinemave, pa marrë parasysh se çfarë filmi shfaqet, kujt i lejohet ta shikojë, e kujt nuk i lejohet.

Me miratimin e këtij ligji do të ndalohen filmat që nxisin dhe mbështesin pornografinë, drogën, prostitucionin. Me emitimin e këtij zhanri jemi dëshmitarë edhe vetë ne se sa ka ndikuar në degjenerimin dhe çoroditjen e rinisë sonë. Andaj, ky ligj do të stopojë të gjitha keqpëdorimet e deritanishme.

Mirëpo, edhe për adhuruesit e filmave ku shfaqen skena të dhunës familjare, skena të dhunës së keqtrajtimit të fëmijëve, skena tmerri – ekspertët e kanë parapa se ky lloj emitimi bëhet vetëm pas orës 22 në kinematë e parapara.

Ajo që është e rëndësishme në këtë ligj, është që parashihen dispozita ndëshkuese dhe kalimtare, gjë që do të ndihmojë në zbatimin e tij.

Po ashtu, propozoj që në fund të çdo viti kalendarik, Ministria e Kulturës në bashkëpunim me qendrën kinematografike të ndajnë shpërblime simbolike për kineastin më të talentuar të vitit, për filmin më të shikuar – kuptohet atë vendor dhe për kinemanë më të modernizuar. Të gjitha këto me qëllim të nxitjes dhe inkurajimit të krijimtarisë kinematografike.

Dhe, në fund mendoj se ky ligj i plotëson standardet ndërkombëtare dhe shqyrtimi në parim lejon që deputetët me aktivitetin e tyre nëpër komisione ta japin kontributin dhe vërejtjet e veta, ku po ashtu në Komision do t'i paraqes edhe unë vërejtjet e mia. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit shumë. Nuk duhet ta lëshoni mbledhjen, sepse shkurt e kemi. Unë e di që jeni lodhur. Prandaj, ju lutem vetëm një sekond përqëndrimi të

vëmendjes tuaj. Besoj se kjo do të jetë seanca e parafundit, sepse këtu nuk kemi as pauzë ku të bëjmë. Përqëndrohuni ta përfundojmë këtë si duhet. Asnjë grup parlamentar në parim nuk ka vërejtje.

Prandaj, kush është për aprovim në parim të ligjit? Ju falemnderit shumë.

A ka kush kundër? Një votë kundër. Ju falemnderit.

A abstenon kush?

15 abstenime, një votë kundër – kalon Ligji në parim. Ju falemnderit shumë.

Votimi – Glasanje – Voted:

- Për – Za – ForShumica – Vecina – Majority.....
 - Kundër – Protiv – Against01.....
 - Abstenime – Uzdržani – Abstained.....15.....
-

Dhe, e kemi pikën e fundit, dhe e besoj se është pikë e shkurtër. Ju lutem për vëmendje.

Është shqyrtimi i propozimit për emërimin e anëtarit të Kryesisë nga radhët e komuniteteve tjera - joshqiptare dhe joserbe.

Më duhet t'i jap disa informacione valide mbi të cilat ju duhet t'i mbështetni ose të përcaktoheni për mendimin tuaj.

Ka disa propozime nga grupacione që kanë dalë me parcializimin ose formëzimin e partisë që i ka fituar zgjedhjet.

Në Kryesi është debatuar më gjatë. Për të gjithë kandidatët që janë propozuar, nuk ka vërejtje. Ka dominuar dhe njëzërit është përkrahur ky parim. Do të merret në konsideratë propozimi i Koalicionit "Vatan" pas krejt shqyrtimeve, sepse kështu edhe jemi vendosur. Ne me një votë formale, duhet të përcaktohem.

Koalicioni "Vatan" ka propozuar kolegen tonë Zehra Elezi, që të jetë anëtare e Kryesisë për këtë vit.

Prandaj, ju lutem të përcaktohem me votim. Nuk ka debat, nuk ka diskutim.

Kush është për?

(Sadik Idrizi, reagon prej vendi - nuk dëgjohe qartë: Gospodine predsedniče mi smo «Vatan», niste vi!)

Ju falemnderit.

Kush është kundër? Të numërohen votat «Kundër».

(Prej vendi, Sadik Idrizi: polemikë, nuk dëgjohe qartë)

Jo, jo – ju lutem. Zehra, uluni ju lutem.

Shiqoni, unë po ju them - ne nuk kemi si Kryesi e Parlamentit parti tjetër...

(Prej vendi, Sadik Idrizi: polemikë, nuk dëgjohe qartë)

Shiqo, ose ulu ose mos bërtit se shkove jashtë! Po, pra. Unë se thash jo, dhe ulu. Zehra ulu. Hilmo, unë thash i kemi shqyrtuar të gjitha kërkesat. Sigurisht se po. Jo, Zehra, ju lutem uluni. Uluni, edhe ju Faik, ju lutem.

Edhe një herë, ju lutem për vëmendje. Unë thash ka shumë propozime. Nuk kemi pasur vërejtje në asnjë propozim. Ka patur debat në Kryesi. Megjithatë, jemi përcaktuar unanimisht për një parim... Kuvendi tash do të votojë.

Po ju them se votuam «për».

Kush është kundër propozimit që Zehra Elezi të jetë anëtare e Kryesisë në mandatin e periudhës së ardhshme?

(Zehra Rushiti prej vendi: nuk dëgjohe qartë.)

ZEHRA RUŠITI:

Poštovani gospodine predsjedniče, uvaženo Predsjedništvo, dame i gospodo, dragi kolege,

Želim da se zahvaljujem mojoj stranci SDA koje je inicirala moje imenovanje za člana Predsjedništva i svima onima koji imali povjerenja u mene i podržali moju kandidaturu. Želim da naglasim da sam zadnja saznala za moju kandidaturu koju je podnela moja stranka a mogu vam reći da sam se našla u vrlo nezgodnoj situaciji iz sledećih razloga.

Kao prvo, inicirala sam i potpisala kandidaturu gospodinu Džezairu Muratiju, što je bio stav većeg dela Parlamentarne grupe, a u međuvremenu je moja stranka podnela kandidaturu za mene. Zbog svega ovoga, došla sam u nezgodan položaj jer nisam mogla da odbijam odluku i stav svoje stranke i izgubim povjerenje svojih birača. Prihvatila sam kandidaturu za člana Predsjedništva. Tokom svoga rada trudila sam se da sa svima u Parlamentarnoj grupi saradjujem, što je išlo vrlo teško.

Prošlog četvrtka ponovo sam pozvala svoje kolege iz «Vatana» da okončamo ovu proceduru. Ali i ovaj sastanak je propao zbog međusobnog neslaganja.

Pojedina gospoda iz «Vatana» imaju samo optužbe na moj rad. Ja vam se obraćam i kažem da sam radom postigla kandidaturu a ne neradom, kako pojedini tvrde. Mislim da sam svojim radom doprinela Bošnjačko-goranskoj zajednici da mogu pokucati na sva vrata Kosova. Da sam ih dostojanstveno predstavljala kako na Kosovu tako i pred međunarodnom zajednicom i da ću se truditi i dalje da radim u njihovom interesu i dobrobiti svih kosovara.

O mom radu neću više govoriti i zamarati vas. Tu ste vi svi moji kolege i kolegenice koji najbolje znate za moj rad, zalaganje i kooperativnosti, konstruktivnosti pri radu. Znam da danas, za neke od vas neće biti lako glasati. Dilema da li glasati po svojoj savjesti ili želji političke partije, čiji ste i član. Ja vas molim ispoštujte stavove svoje partije, kao što sam ispoštovala stav svoje stranke koje me kandidovala. I poraz i pobjedu podneću dostojanstveno. Nezavisno od rezultata glasanja i nadalje ću se truditi da sa vama radim do kraja mandata, onako kako sam radila za dobrobit svih kosovara, za bolju budućnost naše djece, sviju nas i boljeg prosperiteta Kosova. Hvala.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit shumë. Unë ju thash, për kurgjë hiq më. Kemi votuar kush është “për”. Është në radhë për “kush është kundër”. Po, urdhëro edhe ti pra...

HILMO KANDIĆ:

Poštovani kolege, poštovano Predsjedništvo, poštovani predsjedniče,

Ja ću to zadržati kod sebe sigurno, bez razlike i ovako što ste dali na prijedlog da se glasa. Ja bih samo tražio sad ovom prilikom, pošto mi imamo ovde odprilike cjelo Predsjedništvo da jednostavno primjetimo da mene ubjede da je to na Predsjedništvo glasano tako kako ste vi to ovde i iznjeli. Ja samo hoću nešto da kažem i da podsjetim. Ja imam u džepu ovde Ustavni okvir. Vama je poznato da u Parlamentu Kosova postoje dva politička entiteta. Dakle BSDAK i “Vatan”. “Vatan” kao najveći politički entitet sa više poslanika on je imao mjesto ministra. Što izgubio to mjesto, mi nijesmo krivi.

Kao drugi politički subjekt Bošnjaka u ovoj Skupštini mi smo bili... Po svim pravilima i zakonima i razgovorima koje smo imali sa pojedincima iz “Vatana” to mjesto pripada nama. Ja sam govorio da se mi, predsjedniče ne možemo se dogovoriti a onaj dogovor koji sleduje po Ustavnom okviru taj dogovor je ispoštovan. Dakle, određeno je na mandat da svaka grupa zajednice dobije po godinu dana člana svoga Predsjedništva. To je odradila izvanredno i grupa koje je imala prvi mandat, to je odradila dobro i grupa koja je imala drugi mandat. Ovaj treći mandat samo smo mi mogli da se dogovorimo medjusobom ali ne na ovakav način kako ste vi predložili da se navodno izglasa.

Ja ću samo još kazati na kraju. Vaše je pravo sigurno. U našoj stranci samo je bila preporuka da se kaže, vaše je pravo da vi glasate, da glasate za čovjeka za koji vi smatrate... čovjeka koji je kosovsko orijentisan. Medjutim, na ovakav način – predsjedniče – mi ne možemo da usvojimo i da prihvatimo ovog člana Predsjedništva, nego vi nama morate omogućiti jednostavno da mi sjednemo i da se dogovaramo...

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Të falemnderit Hilmo. Urdhëro ti...

SADIK IDRIZI:

Ovo ja doživljam kao pitanje principa. U grupaciji ostalih zajednica je deset trenutno poslanika. Različito, heterogena grupa, različitih etničkih i političkih ubedjenja. U prvom mandatu iz Romske zajednice – član Predsedništva, šef grupe iz Bošnjačke. U drugom mandatu član Predsedništva iz Turske, šef grupe iz Aškalijske. U trećem mandatu iz Bošnjačke a šef grupe iz Turske.

Mi u Bošnjačkoj zajednici «Vatan» i BSDAK najprije treba da se dogovorimo i da politička grupa koja je «ostale zajednice» da to potvrdi. Ta grupa je potvrdila, osam potpisa je dato za gospodina Džezaira Muratija od deset. Ne možete vi tražiti potpunu saglasnost u takvoj grupi. Ali osam od deset, od toga su pet iz Bošnjačke zajednice – tri potpisa iz te zajednice za gospodina Džezairija. To su principi na koje ja insistiram. Nisam... od svih šta se dogodilo nakon toga što se oklevalo da se to postupi. Od pet predstavnika Bošnjačke zajednice u ovom trenutku osim mene sva četvorica su kandidati za tog člana. Znači meni to ne pripada i ne tražim za sebe nego hoću princip, neki ljudski princip da se ispoštuje. Predsedništvo treba da to... Skupština ova treba da potvrdi ono što ćemo mi govoriti. Sutra mogu i drugim grupama da neko kaže da ću vam člana Predsjedništva ili nečega drugog, ili šefa grupe.

Ovo pismo, o kome se raspravlja, koje je juče ili prekjuče došlo od Numana, to je u ime jednog dela koalicije «Vatan», koje ima tri politička subjekta i u ovom trenutku smo dvojica... Znači pola tog subjekta je ovde i za jednu opciju. Ne postoje u Pravilniku političke partije. Postoje poslaničke grupe, i ovde možemo raspravljati ako je poslanička grupa podnela. Niti je «Vatan» politički subjekt kao poslanička grupa. Ovde postoji poslanička grupa «Ostale zajednice» i ona ima verifikaciju neku. Ne postoji... Vi možete izglasati i izabrati. Za nas on neće biti član Predsedništva. Ne da imam ja nešto protiv Zehre, bože sačuvaj. Da smo je mi predložili podržaćemo je. Ali ovo je kršenje elementarnih prava nas «ostalih zajednica». Kad nešto predložimo treba da se i to ispoštuje. I ne može neko umesto mene izabrati mog čoveka. I to je to. Ja vam se zahvaljujem, ali ovo nije dobro.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Vetëm një moment. Ju lutem qetësohuni. Unë kam biseduar me kërkesë të grupacioneve me të gjitha formacionet brenda këtij grupi. Dhe unë kam pa sa është përçarja e thellë brenda...

E dyta, në Kryesi është aprovuar edhe një qëndrim kushtetues, që shkruan edhe në Kornizën kushtetuese. Ky nuk është grup parlamentar kushtetues dhe në Kryesi është humbur kohë edhe për këtë. Prandaj, ka qenë propozim i një anëtari të Kryesisë. Ju kolegët e PDK-ës, nuk ka qenë propozim i LDK-ës në parim.

Dhe, të gjithë e kemi aprovuar. Çka thotë Hydajet Hyseni është krejtësisht jorelevante! Krejtësisht, si gjithmonë. Si gjithmonë që ai ndanë mendimin.

Unë ju thash, ju lutem – kur të hyjë në procedurë, kur të hyjë në procedurë vetëm tenkat dhe armët më ndalin prej procedure. Kemi votuar “kush është për” dhe nuk ka më fjalë. Hydajet më s’ka asnjë fjalë. Nuk do ta marrësh fjalën.

(Hydajet Hyseni, prej vendi: Më keni përmendur emrin. Mos e prish mbledhjen, sepse unë do ta marrë fjalën. Unë kam drejtë ta marrë fjalën.)

Unë thash, nuk e merr fjalën. Nuk ke të drejtë, kemi hyrë në procedurë të votimit. Nuk ke të drejtë, prandaj uluni aty. Shiqo, kur të bëhesh urdhërdhënës i imi, do t’më urdhërosh çka të bëj. Ti e din ku i mbronë drejtat e tuaja, edhe formën e di ti, e cakton shumë mirë.

Ju lutem - Kush është kundër kandidatës Zehra Rushiti? Nuk ka votë kundër.

A ka abstenime? Nuk ka as abstenime.

Prandaj, konstatoj se Zehra Elezi është anëtare e Kryesisë në të ardhmen.

(H. Hyseni, prej vendi: E dua fjalën sepse ma keni përmend emrin, burr.)

Hydajet, jo. Unë nuk të kam ofendue, thash nuk ke fjalë. Zoti, anëtar i Kryesisë nuk ta kam dhënë fjalën.

HYDAJET HYSENI:

Ja, më ke ofendue edhe rënd bile. Po ma ke dhënë fjalën me vetë faktin se ma ke përmendur emrin, zotëri. Rrespektone procedurën, zotri.

(S.Hamiti, prej vendi: Nuk dua me zor me dëgjue fjalime, pikë. Do të dal jashtë!)

HYDAJET HYSENI:

Është e drejtë e tyre të dalin jashtë, por është edhe drejtë e jona t'i theksojmë vërejtjet tona, zotëri.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Rendin e ditës e kemi si pikë të fundit, ju lutem.

Ju lutem, rendin e ditës do ta caktojmë në mbledhjen e ardhshme. Ju falemnderit.

Ju falemnderit për pjesëmarrje. Mbledhja është e përfunduar.

Seanca përfundoi në orën 12,00.

E transkriptoi RT(fq:1-40)Zyra E-04, tel. 038-211-860

Shënim: Shenjat e theksuara në Transkript shënohen vetëm kur:

... diskutuesi nuk përfundon fjalën ose fjalinë.
 nuk kuptohet ç'ka dashur të thotë diskutuesi.
 (Flet ose reagon nga vendi) - nuk dëgjohet qartë.

Napomena: Navedeni znaci u Transkriptu dodaju se samo kad:

... diskutant ne završava reč ili rečenicu.
 se ne razume šta je diskutant hteo da kaže.
 (Govori ili reaguje sa mesta) - se ne čuje jasno.